

Lorana Kasapi aktualisht ushtron detyrën e Këshilltarit Ligjor, në Drejtorinë e Njësisë së Shërbimeve të Përgjithshme Ligjore, pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë, prej muajit korrik 2023.

Në vitin 1996, është diplomuar me titullin “Jurist” në Fakultetin e Drejtësisë, pranë Universitetit të Tiranës.

Në vitin 2008, ka fituar titullin “Avokat” të akorduar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë Tiranë.

Në vitin 2009, zotëron titullin “Avokat Shteti” dhënë nga Ministria e Drejtësisë dhe Avokatura e Shtetit.

Ka një eksperiencë pune mbi 23 vjeçare, në fushën e së drejtës, administratës publike dhe gjyqësore, duke u angazhuar me detyra të ndryshme si, hartim aktesh administrative të brendshme; këshillim juridik; përfaqësim në gjykatë; përfaqësim institucioni në grupet e punës të fushës juridike etj.

Duke filluar nga viti 1998, ka kryer detyrën e juristes së Kabinetit, specialistes në Departamentin Juridik dhe detyrën e Kryetares së Departamentit Juridik, pranë Kompanisë Albtelecom sh.a., në atë kohë me kapital 100% shtetëror.

Zonja Kasapi, ka punuar si “Avokate Shteti” rreth 10 vite, nga vitet 2007-2012, pranë Gjykatave Civile dhe Administrative të Shkallës së Parë dhe Apelit, dhe gjatë viteve 2013-2018, pranë Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese. Gjatë këtij 10 vjeçari, ka mundur të njohë nga afër funksionimin e sistemit gjyqësor në të gjitha shkallët e tij dhe për shkak të shumësisë së proceseve gjyqësore në të cilat ka ushtruar funksionet e përfaqësimit, gëzon njohjen e legjislacionit në shumë fusha të së drejtës.

Zonja Kasapi, për rreth 4 vite ka ushtruar përgjegjësitë pranë institucionit të pavarur publik, Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me detyrat specialiste në Drejtorinë Juridike dhe Këshilltare.

Ka marrë pjesë në trajnime dhe kurse pasuniversitare, të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës, Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA), dhe institucione të tjera që lidhen me veprimtarinë e administratës publike si dhe përfaqësimin gjyqësor.